

	PROCEDURA PËR MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE	PR-CLRR-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 11</i>
<i>Departamenti: ÇËSHIJET LIGJORE DHE RREGULLATIVE</i>		<i>Sektori: ÇËSHIJE RREGULLATIVE</i>

PROCEDURA PËR MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË KUALITETIT DHE FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Labinot Gashi Shukrije Fetahaj	Shukrije Fetahaj SMC	Resmije Ahma DP
Nënshkrimi			
Data			

	PROCEDURA PËR MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE	PR-CLRR-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 11</i>
<i>Departamenti: ÇËSHTJET LIGJORE DHE RREGULLATIVE</i>		<i>Sektori: ÇËSHTJE RREGULLATIVE</i>

Përmbajtja

1 QËLLIMI.....	3
2. FUSHËVEPRIMI.....	3
3. ZBATIMI I PROCEDURËS DHE PËRGJEGJËSIA PËR TË DHËNAT	4
4. PËRSHKRIMI I PROCEDURËS	4
4.1. Periudha e Raportimit.....	4
4.2. Procedura dhe afatet kohore të përgatitjes së raportit.....	4
4.3. Forma e Raportimit	5
4.4. Procesi i shqyrtimit të standardeve ekzistuese	10
5. FORMULARËT/DOKUMENTET.....	10
5.1. Burimet	10
5.2 Dokumentet dhe formularët	10
6. ANEKSET	11
6.1. Lista e shpërndarjes	11
6.2. Shënimet për versionet.....	11

	PROCEDURA PËR MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE	PR-CLRR-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 11</i>
<i>Departamenti: ÇËSHTJET LIGJORE DHE RREGULLATIVE</i>		<i>Sektori: ÇËSHTJE RREGULLATIVE</i>

1. QËLLIMI

Procedura për monitorimin e përmbushjes së standardeve të kualitetit dhe shërbimit me energji elektrike përmban rregullat për përgatitjen e raportit mbi monitorimin e përmbushjes së këtyre standardeve. Qëllimi i kësaj procedure është vendosja e procesit të raportimit mbi monitorimin e përmbushjes së Standardeve të Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike. Dokumenti Standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike është punuar nga grupi punues ZRrE, KOSTT, KEK dhe MZHE me ç'rast janë propozuar standardet e kualitetit për secilën palë e ndër të tjera janë propozuar standardet e kualitetit edhe për Operatorin e Sistemit të Transmisionit sipas kushteve të Kosovës dhe të cilat janë aprovuar nga ZRrE.

2. FUSHËVEPRIMI

Kjo procedurë është hartuar në bazë të obligimit nga Neni 17 (paragrafi 3) i Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmisionit (OST). Procedura e hartuar nga KOSTT-i do t'i nënshtrohet procesit të aprovimit nga ZRrE. KOSTT do të veprojë në pajtueshmëri me procedurën e aprovuar.

Paragrafi 1 (Neni 17) i licencës në fjalë, obligon të licencuarin që të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha standardet e aprovuara të cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike.

Poashtu edhe në bazë të Ligjit për Energjinë Elektrike Neni 12, paragrafi 1.7, Operatori i Sistemit të Transmisionit është përgjegjës për veprimin në pajtueshmëri me të gjitha standardet e cilësisë së furnizimit dhe sigurisë së sistemit që përcaktohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Duke u bazuar në kërkesat nga Licenca e OST, kjo procedurë përcakton përgjegjësit për zbatim të kësaj procedure, përgjegjësit për grumbullimin dhe kalkulimin e të dhënave dhe për përgatitjen e raportit final për ZRrE dhe thekson afatet kohore dhe formën e raportimit.

	PROCEDURA PËR MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE	PR-CLRR-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 11</i>
<i>Departamenti: ÇËSHIJET LIGJORE DHE RREGULLATIVE</i>		<i>Sektori: ÇËSHIJE RREGULLATIVE</i>

3. ZBATIMI I PROCEDURËS DHE PËRGJEGJËSIA PËR TË DHËNAT

Kjo procedurë duhet të zbatohet nga Departamenti i Operatorit të Sistemit dhe Departamenti për Çështje Ligjore dhe Rregullative (DÇLR). Operatori i Sistemit është përgjegjës për grumbullimin dhe kalkulimin e të dhënave për standardet ekzistuese për vitin paraprak dhe përcaktimin (propozimin) e qaveve të këtyre standardeve për vitin në vijim. DÇLR është përgjegjës për kompletimin, konfirmimin dhe dërgimin në ZRrE të raportit për standardet e kualitetit të furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike.

4. PËRSHKRIMI I PROCEDURËS

4.1. Periudha e Raportimit

Periudha e raportimit në ZRrE është e përcaktuar në paragrafin 4, Neni 17 i Licencës së OST-së, ku është përcaktuar saktësisht se KOSTT-i do të raportojë në baza vjetore dhe atë jo më larg se data 31 Mars e çdo viti, si dhe për ndonjë periudhë tjetër nëse kjo kërkohet nga ZRrE.

4.2. Procedura dhe afatet kohore të përgatitjes së raportit

Në bazë të përgjegjësiave të përcaktuara në detyrat e punës, procedura e përgatitjes së këtij raporti inicohet nga stafi përgjegjës i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Rregullative (DÇLR), duke njoftuar stafin përkatës të Departamentit të Operatorit të Sistemit lidhur me përgatitjen e këtij raporti brenda afatit kohor.

DÇLR në periudhën (3 -10) Shkurt të çdo viti kalendarik, do të njoftojë departamentin përkatës për përgatitjen e raportit mbi ushtrimin e veprimtarisë lidhur me standardet që duhet përmbushur në pajtueshmëri me detyrimet nga dokumenti Standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike.

Operatori i Sistemit, nga data 11 Shkurt – 01 Mars të çdo viti kalendarik do të raportojë mbi pajtueshmërinë me këto standarde. Nga (02 – 07) Mars Sektori për Çështje Regullative bën konfirmimin e të dhënave të raportuara nga OS. Konfirmimi i të dhënave bëhet duke krahasuar të dhënat përfundimisht të mbyllura për vitin paraprak.

	PROCEDURA PËR MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE	PR-CLRR-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 11</i>
<i>Departamenti: ÇËSHIJET LIGJORE DHE RREGULLATIVE</i>		<i>Sektori: ÇËSHIJE RREGULLATIVE</i>

Pas pranimit të të gjitha raporteve nga Operatori i Sistemit mbi rezultatet e arritura, brenda periudhës (08 – 15) Mars, Sektori për Çështje Regullative përgatitë draft raportin në format të caktuar.

4.3. Forma e Raportimit

Në Tabelën në vijim janë paraqitur Standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike, të aprovuara nga ZRrE për Operatorin e Sistemit të Transmisionit (OST). Në bazë të formës së përcaktuar në këtë tabelë, KOSTT raporton në ZRrE lidhur me përmbushjen e standardeve të aprovuara (Raporti për vitin N-1) si dhe propozimet për caqet e këtyre standardeve për vitin në vijim (Kualitetet Matëse). Gjithashtu plotësohet edhe kolona e fundit me të dhënat për vitet paraprake në formë të historikut.



Nr.	Titulli	KUALITETET MATËSE	Raporti për vitin N-1	Shënime
1.	TS1: SAIDI (Indeksi i Kohëzgjatjes së Ndërprerjeve Mesatare)	<p>Indeksi i Kohëzgjatjes së Ndërprerjeve Mesatare të Sistemit (SAIDI) nënkupton kohëzgjatjen e ndërprerjeve mesatare për çdo konsumator të furnizuar, që përfshinë të gjitha ndërprerjet që rezultojnë nga ndërprerjet në sistemin e transmisionit. Ky indeks paraqet kohën mesatare të orëve të humbura për konsumator, si rezultat i ndërprerjeve në sistemin e transmisionit dhe llogaritet sipas formulës në vijim:</p> $SAIDI = \frac{\sum DI_t}{\sum C_t}$ <p>Ku: DI_t - paraqet kohëzgjatjen e ndërprerjeve të të gjithë konsumatorëve që ndodhin gjatë vitit t, e matur në orë/minuta. C_t - paraqet konsumatorët e shërbyer gjatë vitit kalendarik t. Operatori i Sistemit të Transmisionit do të angazhohet maksimalisht për të siguruar që vlera e SAIDI-t për vitin kalendarik N+1 nuk do të tejkalojë:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ [xxx] minuta për konsumator sa i përket ndërprerjeve të planifikuara, ku ndërprerje të planifikuara përkufizohen ato ndërprerje që evidentohen (regjistrohen) sipas standardit të kualitetit TS5, dhe▪ [Y] orë për konsumator sa i përket ndërprerjeve të paplanifikuara, ku ndërprerje të paplanifikuara janë të gjithë ndërprerjet tjera relevante përpos ndërprerjeve të planifikuara.	Raportohet për vitin N-1	Raportohet për vitet paraprake N-2, N-3 etj.



Nr.	Titulli	KUALITETET MATËSE	Raporti për vitin N-1	Shënime
2.	TS2: SAIFI i Shpeshhtësisë (Frekuencës) Mesatare të Ndërprerjeve të Sistemit).	<p>Indeksi i Shpeshhtësisë (frekuencës) Mesatare të Ndërprerjeve të Sistemit (SAIFI) nënkupton numrin mesatar të ndërprerjeve që ndodhin për çdo konsumator të furnizuar, që përfshinë të gjitha ndërprerjet që rezultojnë nga ndërprerjet në sistemin e transmisionit. Ky indeks paraqet numrin e ndërprerjeve të konsumatorëve, si rezultat i ndërprerjeve që ndodhin në sistemin e transmisionit dhe llogaritet sipas formulës në vijim:</p> $SAIFI = \frac{\sum I_t}{\sum C_t}$ <p>Ku: I_t - paraqet numrin e ndërprerjeve të konsumatorëve që ndodhin në vitin t. C_t - paraqet konsumatorët e furnizuar gjatë vitit t.</p> <p>OST do të angazhohet maksimalisht për të siguruar që vlera e SAIFI-t për vitin kalendarik N+1 nuk do të tejkalojë:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ [xxxx] ndërprerje për konsumator sa i përket ndërprerjeve të planifikuara, ku ndërprerje të planifikuara përkufizohen ato ndërprerje që regjistrohen sipas standardit të kualitetit TS5 dhe▪ [Y] ndërprerje për konsumator sa i përket ndërprerjeve të paplanifikuara, ku ndërprerje të paplanifikuara janë të gjithë ndërprerjet relevante përpos ndërprerjeve të planifikuara.	Raportohet për vitin N-1	Raportohet për vitet paraprake N-2, N-3 etj.



Nr.	Titulli	KUALITETET MATËSE	Raporti për vitin N-1	Shënime
3.	TS3: Numri dhe kohëzgjatja e devijimeve të frekuencës	Në rast të devijimeve të frekuencës jashtë vlerave nominale të përcaktuara me Kodin e Rrjetit, KOSTT do të raportoj në Raportet e rregullta vjetore (jo më vonë se 31 Mars të çdo viti)		
4.	TS4: ENS (Energjia e Pa Furnizuar)	Energjia e pa-furnizuar për shkak të të gjitha llojeve të ndërprerjeve që rezultojnë nga ndërprerjet e transmisionit definohet si: $ENS = \sum_t E_t$ Ku E tregon energjinë e pa-furnizuar (EPF ose në anglisht ENS) në MWh si rezultat i çdo ndërprerje që ndodh në sistemin e transmisionit. OST do të angazhohet maksimalisht për të siguruar që vlera e energjisë së pa furnizuar (EPF) në vitin kalendarik N+1 nuk do të tejkalojë [xxxx] GWh.		



Nr.	Titulli	KUALITETET MATËSE	Raporti për vitin N-1	Shënime
5.	TS5: Periudha minimale e njoftimit për ndërprerjet e planifikuara të sistemit të transmisionit.	<p>Në rastet që OST-ja bën ndërprerje të planifikuara në sistemin e transmisionit, ajo do të angazhohet maksimalisht për të siguruar që të paktën në 90% të rasteve t'i ofrojë OSSH-së si dhe konsumatorëve të prekur njoftim brenda 48 orësh.</p> <p>Për qëllime të këtij standardi, për ndërprerjet që ndodhin në zona lokale (më të kufizuara) konsumatorët e prekur do të njoftohen nëpërmjet televizionit (TV-së) dhe radios lokale. Ndërsa për ndërprerjet që ndodhin në zona më të gjëra aty ku ndërprerja është mjaftë e përhapur, konsumatorët do të njoftohen përmes një TV-je dhe një gazete nacionale, me qarkullim të gjerë ditor.</p>		

	PROCEDURA PËR MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE	PR-CLRR-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 11</i>
<i>Departamenti: ÇËSHTJET LIGJORE DHE RREGULLATIVE</i>		<i>Sektori: ÇËSHTJE RREGULLATIVE</i>

Sqarim për përmbajtjen e të dhënave në tabelë:

Titulli – paraqet fushën në të cilën shënohet Numri dhe Emërtimi i Standardit,

Raporti për vitin N-1 – është fusha brenda së cilës raportohet mbi përmbushjen e standardit përkatës për vitin paraprak.

Shënim Shtesë – paraqet fushën në të cilën zyrtari përkatës i KOSTT-it mund të paraqet të dhëna më të detajuara (nëse posedohen) për pajtueshmërinë me standardin përkatës apo argumente mbi mos pajtueshmërinë lidhur me këtë paragraf.

4.4. Procesi i shqyrtimit të standardeve ekzistuese

Duke u bazuar në paragrafin 2 të Nenit 17, të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit, kur ZRrE kërkon apo kur KOSTT e konsideron si të arsyeshme, KOSTT do të shqyrtoj standardet ekzistuese të përgjithshme dhe minimale të përmbushjes të listuara në tabelën e mësipërme. Nëse ka ndryshim në këto standarde ekzistuese atëherë nuk do të jetë e nevojshme që kjo procedurë të dërgohet përsëri për aprovim në ZRrE pasi që paraprakisht ndryshimi apo plotësimi i standardeve duhet të aprovohet nga ZRrE.

5. FORMULARËT/DOKUMENTET

5.1. Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1.	Ligji për Energjinë Elektrike
2.	Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit

5.2 Dokumentet dhe formularët

- Raporti mbi pajtueshmërinë me Standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike

	PROCEDURA PËR MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE	PR-CLRR-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 11</i>
<i>Departamenti: ÇËSHTJET LIGJORE DHE RREGULLATIVE</i>		<i>Sektori: ÇËSHTJE RREGULLATIVE</i>

6. ANEKSET

6.1. Lista e shpërndarjes

Nr.	Emri dhe mbiemri	Data	Nënshkrimi
1.	Sabri Musiqi, Drejtor i Departamentit të Operatorit të Sistemit, KOSTT		
2.	Resmije Ahma, Drejtoreshë e Departamentit për Çështje Ligjore dhe Rregullative, KOSTT		

6.2. Shënimet për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.0	10.07.2013	Versioni Inicial	5 Vite